



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 73, datë 12.07.2022

PËR
MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2'000'000 (DY MILION) LEKË PËR
MBËSHËTETJEN FINANCIARE PËR ORGANIZIMIN E PANAIRIT "FESTIVALI
VEROR I LIBRIT, GUSHT, DURRËS 2022"

Në mbështetje të Ligjit Nr.139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 23.12.2021 "Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2022, si dhe Projektbuxhetin Afat Mesëm 2022-2024", si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Turizmit, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 2'000'000 (dy milion) lekë për mbështetjen financiare për organizimin e Panairit "Festivali Veror i Librit, Gusht, Durrës 2022".
2. Ky fond do të merret, i detajuar si më poshtë vijon :

- a. Fondi në masën 1'700'000 (një milion e shtatëqind mijë) lekë do të përballohet nga fondi për panairë për promovimin e qytetit, i miratuar në buxhetin e vitit 2022 me VKB-në nr.158, datë 23.12.2021;
 - b. Fondi në masën 300'000 (treqind mijë) lekë do të përballohet nga fondi rezervë, i miratuar në buxhetin e vitit 2022 me VKB-në nr. 158, datë 23.12.2021.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Turizimit, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Buxhetit.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 13.07.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 570/3 prot.

Durrës, më 18.07.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
Durrës**

**KRYETARIT TË BASHKISË
Durrës**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashk ak Durrës Nr.73 datë 12.07.2022 Për miratimin e përdorimit të fondit prej 2.000.000(dy milion) lekë për mbështetjen financiare për organizimin e panairit “Festivali veror i librit, Gusht, Durrës: 2022”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
EMILJAN JANI